



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nº Br. No. 01-060-01-20439-29
Nº i fq. / Br.str. / No.pg.
Data / Datum / Date 18.07.2024
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq
E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal e mbajtur me dt.26.06.2024, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal. **Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Plana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjere: Ibush Mjekiqi, Nënkyrytar i Komunës, drejtore komunal, Haki Jashari, drejtore i QKMF-së, përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Planifikimi i buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DSHMS-së, për Draft Statutin e QKMF-së, "Forma unike e Statutit të QKMF-së"
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DPUKP-së, lidhur me kërkesën e njësisë KUR Prishtina në Obiliq
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 21 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 21 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e DEFZH-së, për shqyrtimin dhe aprovimin e planifikimit të buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027.

Enver Gashi – Ne e kemi debatuar këtë buxhet dhe e kemi dhënë kontributin tonë si grup parlamentar, kështu që jemi për aprovimin e këtij Draft buxheti.

Sami Ahmeti – Unë isha fokusue në 2 çështje dhe çështja e parë është çështje teknike që vazhdon të na sjellet materiali tepër i vështirë me lexue. Këtë, po e them kështu përfaktin se në verzionin e gjuhës shqipe që na ka ardhë dhe që na vjen vazhdimisht materialet janë të fotografuara aq dobët sa që është vërtetë vështirë me lexue, janë të inkriptuara në një dokument në PDF, ku disa fletë janë djathtas e disa majtas, disa përpjetë e disa tjera ndryshe. Në ndërkokë në verzionin në gjuhën serbe ka ardhë pikërisht ashtu siç do të duhej të ishte. Ne si grup nuk e pranojmë dhe nuk e dojmë diskriminimin çfarëdo qoftë ai pozitiv, apo negativ. Materiali në verzionin exell ka ardhë i kategorizuar ashtu siç duhet, por ka ardhë vetëm në gjuhën serbe duke marrë parasysh që shumica, të paktën e grupit tonë nuk janë njohës të gjuhës serbe dhe ju kisha lutë që herave tjera me pasë kujdes. Sa i përket pjesës tjetër të buxhetit dhe përbërjes së tij është një përsëritje dhe shumë projekte po barten nga një vit në vitin tjetër. Unë e kupoj që është planifikim dhe jo gjithmonë planifikimet funksionojnë ashtu siç planifikohen, megjithatë edhe çështjet madhore që janë thënë në fushata zgjedhore siç është pishina gjysëm olimpike, po duket se po bartet përvitit 2026 rrjedhimisht, jo për këtë mandat. Po ashtu, investimet kapitale rrugët dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me të mirën qytetare disi po shtyhen pas zgjedhjeve, sikurse me dashtë me i mbajtë qytetarët varë që nëse nuk na votoni neve, nuk bëhen kështu. Këto, investime kapitale përmbajnë në vete më pak se 100,000 €, dhe vazhdimisht po shtyhen prej vitit në vit. Këto, janë vërejtjet tona, mund të ketë edhe vërejtje tjera, por nuk më duket se është buxhet serioz.

Ajet Berisha – Unë nuk është që kam dallim të madh në atë çfare është paraqitë, por janë kërkesa praktike që nga përditshmëria jonë dhe nevojat që i vërejmë në terren, mendoj se kemi disa mangësi apo disa nevoja që diçka me ndryshue. Ajo që më bjen në sy fillimi është te mallrat dhe shërbimet, flas përvendin aty ku punoj që ka të bëjë me shëndetësi, material laboratorik, ampullar, stomatologjik dhe gjinekologjik në total janë të parapara 55,000 €. Këtu, është edhe drejtoresha që me siguri ka edhe informata dhe është edhe drejtori në këtë rast dhe ju siguroj se në njësinë e emergjencës shumë shpesh ndodhë që gjërat elementare mungojnë. Unë e di se përlidhështë përgjegjëse Ministria e shëndetësisë, por ka diçka këtu që ne mundemi minimalisht këtë element me eliminue. Mendoj se kjo shifër prej 55,000 €, edhe po të shkoj në 100,000 €, prapë nuk do ti mbuloj kërkesat dhe nevojat që janë minimalisht emergjente. Do të thotë është një diçka që neve si njësi shpesh herë ndjehemi shumë këq, përvitë rast që e dijmë se edhe pas orës 11 barnatoret mbyllen, vjen ndonjë rast urgjent dhe ne nuk e kemi atë barnë. Fatbardhështë tash jemi duke i rritur pikërisht përvitë shkak të kësaj situate, duhet me pritë që materialin thelbësor me rritur që pas orës 11 me pasë. Duke pasë përvitë bazë këtë element jo me fajësue Komunën, as askend por me paraqitë si nevojë që minimalisht kjo shumë e mjeteve të shkoj në 100,000 €. Është kërkesë e imja dhe nuk hy me analizue pjesën tjetër, i dini ju nevojat sepse çdo ditë jeni me shpenzime komunale, por është me rëndësi edhe te investimet kapitale, që prej investimeve më të qëlluara është ngrohja qëndrore. Mirëpo, fatkeqështë ky investim kapital është duke ndikuar jashtëzakonisht shumë në investimet tjera kapitale që kanë nevojë qytetarët. Prandaj, kjo duhet me rritë vigjilencën sidomos të Ekzekutivit që mjete përvitë shpesh qëndrore me u sigurue nga vijat tjera. Këto mjete mund të sigurohen në emër të mbrojtjes së mjedisit, në emër të realizimit të Ligjit të Obiliqit, nga Ministria e mjedisit dhe nga Ministratë tjera. Mendoj se është dashtur me ndihmues në këtë drejtim sepse Komuna, duke u koncentruar në këtë investim jashtëzakonisht kanë mbetë keq disa investime tjera të domosdoshme si në Arsim, mjedis e kulturë. Kjo, është një hendikep shumë i madh përkundër që krejtë qytetarët janë përvitë investim, por siç po shihet ky investim do të zgjatë shumë dhe pjesët tjera të interesit qytetar do të mbeten prapa. Duke pasë përvitë këtë, është një vërejtje e madhe përvitë Ekzekutivin, që ka mungue iniciativa përvitë me sigurue mjete o nga Ministratë, o nga banka botërore apo nga elemente tjera, që janë të gatshme përvitë me ndihmues në mbrojtje të mjedisit. Unë do ta votoj, por me këtë vërejtje dhe sugjerime që me u bë disa ndryshime.

Valon Svirca – Ndoshëta, edhe unë jam në gabim por te rr. "Hasan Hasani" nuk e di a është planifikue përvitë vit, apo përvitë 2025-2027. Nën kryetari veç është në dijeni se te Migena aty është një problem pronësor që e kemi diskutuar më heret, por aty është problemi që duhet të bëhet rruga 3 metra, ose më pak dhe ajo lagje është e pajtimit me shkue në atë sistem, por unë këtu nuk po e shohë a është përvitë vit, apo përvitë tjetër.

Ajet Berisha – Është viti i dytë që njësia apo pjesa e paliativit që punon në QKMF me rritjen e buxhetit apo me hyrjen në fuqi të Ligjit për paga, ajo pjesë e stafit shëndetësor kanë mbetë me paga qysh kanë qenë para ligjit. Do të thotë me 380 €, është infermieri, ndërsa mjeku është me 550 €. Unë në vitin e kaluar e kam bërë një kalkulum për 3 vite, që kemi mund me mbulue atë pjesë për këtë staf që janë me shumë interes për qytetarët e Komunës, kanë qenë 72,000 €, për 3 vite në rast se të gjitha mbulohen nga Komuna. Tash, ka shkue veç 1 vit, që konsideroj se ka mundësi me u kalkulue dhe ju lus për mirëkuptim sepse është një lloj diskriminimi që bëhet e njejtë punë nga profesionistët e njejtë dhe ata kanë paga më të ulëta dikund për 30-40 %. Mendoj se kishte me qenë me interes edhe për hir të mbulimit, korrektësisë edhe për hir të mungesës së diskriminimit për punën e njejtë pagesa e njejtë, që kjo pjesë a është 50,000 €, a është 60,000 €, mund të kalkulohet. E kisha lutë edhe Drejtorinë e shëndetësisë dhe Drejtorinë e financave, me kalkulue këtë pjesë që me ua mbulue. Vërtetë, është një diskriminim ndaj tyre sepse e di që Komunat tjera, i kanë marrë këta hapa dhe e kanë bërë këtë mbulim të kësaj pjesë, që këta mos të ndjehen të diskriminuar.

Ibush Mjekiqi – Ne kemi pasë më se një muaj e gjysmë debate të organizuara lidhur me buxhetin për vitin 2025 edhe siç e keni parë edhe ju vetë në materialin e juaj në hyrje buxheti për vitin 2025 është 14 milionë e 516,133 €, i ndarë në 5 kategori buxhetore: paga dhe meditje 5 milionë e 480,000 €, mallra dhe shërbime 1,900,00 euro, shpenzime komunale 300,000 €, subvencione dhe transfere 1,100,000 €, dhe investime kapitale 5,736,133 €. Është e vërtetë se kogjenerimi merrë pjesën më të madhe të buxhetit për investime kapitale, por nuk është se nuk kemi bërë përpjekje në këto 3 vite për të siguruar donacione të ndryshme, jemi ende akoma dhe kemi gjasa të përfitojmë. Sido që të jetë ende nuk ka ndodhë dhe nuk mund të them me saktësi se kur do të ndodhë, por përpjekjet asnjëherë nuk janë ndalë dhe nuk do të ndalen. Pajtohem plotësisht se kanë mbetë disa punë tjera të nevojshme, por edhe ato do të realizohen. Sa i përket çështjes së pagave, e dijmë se ata janë staf shtesë i anagzhuar dhe ne e kemi ble atë shërbim, kështu që është mirë me organizatën me të cilën e kemi kontratën të kontaktohet dhe nëse, pranon me rritë pagën organizata caritas relief Islamic edhe ne pranojmë dhe nuk paraqet problemi me rritë pjesën tonë. Pra, organizata duhet me rritë pagën sepse ata janë punëtorë të tyre, do të thotë duhet ndjekë këta hapa dhe ndryshe nuk kalkulohet. Sa i përket shërbimeve dhe mallrave, duke pasë parasysh 11 vitshin e fundit, gjithmonë kam qenë në ngjarje me shëndetësi, mendoj se mjetet në shumën prej 55,000 €, janë sasi e mjaftueshme për blerjen e materialit mjekësor, ampullar, gjinekologjik e tjera sepse edhe pjesa tjeter e Ministrisë së shëndetësisë përmes kontratës që e ka përbarnat esenciale është e obliguar të furnizoj. Mirëpo, unë jam shumë i sigurtë që keni informacion edhe ju se kurrënjerë deri më tanë për këto 11 vite, nuk ka arritë ta përbushë në masën qind për qind, por furnizimi ka shkue në 40-50 %. Nëse, paraqitet nevoja për blerje shtesë atëherë prej kategorisë shërbime dhe mallra mund të shfrytëzojmë mjete dhe prej Drejtorive tjera. Drejtoria e ka paraparë 55,000 €, duke u bazuar në kontratën 3 vjeçare që është 55,000 €, për çdo vit. Te çështja rr. "Hasan Hasani" nuk kemi mund me përfshi në buxhet dhe në vijë buxhetore, por në buxhet është vija e bashkëfinancimit që nëse, zgjidhet problemi kontestimor që është aty, me një marrëveshje përmes kategorisë shërbime dhe mallra me bashkëfinancim, do ta financojmë. Vërtetë, Ekzekutivi dhe Drejtoria përkatëse është e interesuar që kjo rrugë të përfundoj sepse është në qendër të qytetit. Disa rrugë tjera në Mazgit veç tash fillojnë, janë të nënshkruara po flas për Mazgitin e Poshtëm dhe nëse, nuk kanë filluar në këtë javë besoj se shumë shpejtë do të fillojnë së realizuari që kanë qenë edhe më heret, por për shkak të problemeve të ndryshme është shkëput ajo kontratë dhe tash vetëm fillojnë. Unë ju ftoj që ta votoni këtë buxhet të paraparë për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027.

Ajet Berisha – Sa i përket të parës pajtohem plotësisht se është dashtë me u inicue me Islamic relief që kjo punë me u përmirësue sa më shpejtë që është e mundur për hir të stafit. Mendoj se drejtoresha bashkë me drejtorin kanë me marrë përsipër këtë punë në mënyrë urgjente meqë, nuk po mungojnë mjetet që kjo punë me u krye. Sa i përket buxhetit përmirësuar që kjo punë me u krye, mendoj se më mirë kishte qenë që këto 100,000 €, me u dedikue për këtu, dhe në rast se ka nevojë me u ternerë nga Drejtoritë tjera, se sa me mungue në këtë linjën tonë, pastaj me bë kërkesa tjera për me u realizue diçka që është shumë emergjente dhe shumë e nevojshme. Këtë, e din edhe drejtori i QKMF-së, e dini edhe ju Nënkyrjetar sa e rëndësishme është që pa këto elemente QKMF-ja, mos me mbetë.

Ibush Mjekiqi – Unë e kuptoj plotësisht z. Ajet dhe kisha dashtë që edhe ai të më kuptoj mua, për shkak të kontratës që e kemi eshtë dashtë me planifikue për shkak të auditimeve, përndryshe nuk na paraqet problem edhe nëse, paraqitet nevoja edhe përfundim më të madh edhe nëse, e kalon 100,000-in.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 16 vota për dhe 5 vota abstineni morën Vendim Aprovohet (KASH) Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2025 dhe parashikimet (2026-2027).

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti hqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DSHMS-së, për Draft Statutin e QKMF-së, “Forma unike e Statutit të QKMF-së”.

Haki Jashari – Ka më se 6 vite, që Drejtoria e shëndetësisë dhe QKMF-ja, kemi pasë kontakte dhe nuk e kemi pranuar ofrimin e një Statuti të cilin nă e ka dhënë Ministria e shëndetësisë, për arsy se atakohet rëndë shëndetësia dhe planet që janë për Komunën e Obiliqit. Ne kemi kërkuar vetëm që të implementohet Ligji për Obiliqin, neni 2 pika 1.3 dhe 1.5 por deri më tani nga Ministria e shëndetësisë nuk kemi marrë ndonjë përgjegje me përjashtim nga Zyra ligjore, që nuk eshtë ndonjë përgjegje që ia vlen të përmendet. Po ashtu, kemi marrë edhe një përgjegje nga Zyra e Kryeministrisë, që Ligji të kthehet dhe të specifikohen çështjet tjera. Ne kemi kërkuar që të formohen grupe inicuese në mes neve dhe Ministrissë së shëndetësisë, kam bërë konsulta edhe me ekspertë të lëmive të ndryshme, duke përfshirë edhe konsulentë ndërkombëtar për këtë Çështje. Meqë eshtë një formë e panjohur për ne, ka mundësi të merren forma teknike nga propozimet e organizatave botërore të shëndetësisë dhe organizatave tjera. Rekomandimet e Komisionit janë që të kemi shërbime konsultative, shërbime specialistike që nënkupton të kemi shërbime në gjinekologji, shërbimin e pediatrisë dhe pse jo shërbimin e specialistit për sëmundje të mushkërive, qoftë edhe duke na dërguar nga spitali së paku 1 ose 2 herë në javë. Avancimi i shërbimit diagnostik, laboratorëve dhe shërbimit radiologjik ka vite që ne i kemi përbushë të gjitha obligimet ligjore. Një çështje shumë e ndjeshme për neve eshtë formimi i shërbimit shtëpiak paliativ që kemi kërkuar shtimin e numrit të personelit dhe morën konfirmimin se Ministria e shëndetësisë nuk mund të financoj ekzistimin e këtij shërbimi, që ne veç e kemi. Një problem tjetër i joni eshtë inicimi i hulumtimeve si pasojë e ndotjes së ambientit, që përvèç një hulumtimi para disa viteve nga Instituti kombëtar i shëndetit public, nuk ka ndodhë më. Pika 5 eshtë krijimi i një fondi nga Qeveria për subvencionimin e qytetarëve të sëmurë si pasojë e ndotjes mjedisore. Ne kemi kërkuar që Statuti i QKMF-së, të pranohet vetëm duke implementuar edhe Ligjin për Obiliqin, që pastaj ne të përfitojmë ajo çka na takon me ligj.

Kryesuesja – Pra, rekomandim nga Komisioni eshtë të aprovohet Statuti i QKMF-së, por duke implementuar Ligjin nr.05/L-044 për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rrëth tij, konkretisht neni 2 pika 1.3 dhe 1.5.

Enver Gashi – Ne me plot gojën po flasim ligji, ligji dhe Ligji për Obiliqin nuk eshtë ligj që duhet me respektue vetëm Obiliqi, por edhe pushteti qëndror duhet me respektue e nëse, nuk e respekton atëherë dihet kush e ka fajin. Ne si grup parlamentar jemi për atë që ky Statut të kaloj në Kuvend me këto plotësimë, duke u mbështetur në Ligjin për Obiliqin dhe dihet se ai që nuk e zbaton ligjin bën vepër kriminale.

Sami Ahmeti – E thamë edhe në mbledhjen e KPF-së, se çdo gjë që eshtë e rëndësishme për përmirësimin e jetës dhe shëndetit të qytetarëve ne jemi pro. Në këtë fushë ne nuk eshtë që kemi ndonjë ekspertizë edhe i marrë si të mirëqena edhe rekomandimet e Komisionit, rekomandime këto që mund ta përmirësojnë jetën e qytetarëve. Ne të gjithë dimë një diçka bazike çka eshtë sistemi primar, sekondar dhe ai terciar si dhe e dimë çka mundet me pasë një Komunë me këtë afat tjetrin sistem. Megjithatë, edhe unë pajtohem duke pasë parasysh që Obiliqi ka rrëthana tjera, Obiliqi e ka një ligj të veçantë për të cilin deri vonë fokus ka qenë vetëm renta minerale dhe nuk ka qenë fokus diçka tjetër. Unë pajtohem që të implementohen këto, edhe pse po më duken pak si prapësht sepse fillimisht do të duhet që të nxjerren aktet nënligjore me aq sa kemi kompetenca dhe mundësi do të provojmë me shtye përpara. Ligji që po ceket neni 2 dhe paragrafet deri në 1.5 ose 1.6 eshtë pak i mangët dhe secili mund ta komentoj në formën e vet. Gjithsesi, ne jemi pro këtyre rekomandimeve, me shpresë se nuk do të përfundojnë përsëri në nul përfundim se nganjëherë po marrim rekomandime që nuk na takojnë.

Ajet Berisha – Ajo çfarë ka bërë Komisioni është se ka kërkuar nga Ministria e shëndetësisë në një dokument që është shumë i rëndësishëm për funksionimin e shëndetësisë në Komunën tonë të implementohet ligji, apo pjesë nga ligji që kanë të bëjnë me shëndetësinë. Mendoj se drejtori i dha shpjegimet e mjaftueshme dhe u bazue në pikat, apo në net e Ligjit për Obiliqin, që janë plotësish të qarta që e kanë përgjegjësinë e adresuar. Do të thotë është neni 2 pika 1.3 dhe 1.5 ndërsa neni 10 e adreson përgjegjësinë e kujt është kjo dhe neni 11 për ato akte të munguara, që ka qenë obligative që këto të realizohen 6 muaj pas miratimit të ligjit. Rekomandimet janë të qëlluara dhe fatkeqësisht, unë jam i bindur prapë nuk do ti zbatoj Ministria, arsyet nuk i di pse ata nuk dojnë me zbatue ligjin. Sado që mund të jenë të mjequllta kërkesat është shumë e qartë thotë të krijohen mundësitë e veçanta për banorët e Obiliqit në aspektin shëndetësor. Do të thotë se është e qartë se në kuadër të këtij neni jepë mundësi që në kuadër të Statutit të QKMF-së, minimalisht stafi të shtohet për shkak të specifikave dhe nevojave që i ka terreni. Minimalisht duhet të shtohen disa subvencionime që kishin me iu ndihmues atyre, që preken nga ky mjedis. Unë plotësish pajtohem edhe me shpjegimin edhe me kërkesat e bazuara, pikërisht në Ligjin për Obiliqin dhe mendoj se adresohen saktë sepse realizimi i tyre është Ministria e shëndetësisë dhe Ministritë tjera, kështu që ne rekomandimin e përkrahim të shohim sa do të na ec edhe lartë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për morën Vendim Aprovohet Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Obiliq.

Pika 5-e rëndit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e DPUKP-së KUR Prishtina në Obiliq, për vazhdimin e afatit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

Arben Berisha – Komisioni e ka vërtetuar se kompanisë KUR Prishtina, i ka skadue kontrata që e ka pasë për 10 vite, dhe ne si Ekzekutiv në bazë të ligjit jemi të obliguar me raportue në Kuvend çdo 6 muaj, për pronat e marra dhe për mendimin tonë për vazhdim ose anulim të kontratës. Ne e kemi dërgue për me vazhdue kontratën duke marrë parasysh se kompania në fjalë është kompani shtetërore dhe është në shërbim të qytetarëve. Ne e kemi marrë një kërkesë nga Komiteti për sqarime të mëtutjeshme, i kemi bërë shkresë kompanisë në fjalë dhe kemi kërkuar të na i sqaroj kërkesat e anëtarëve, se a ka makineri tjetër dhe a posedon ndonjë parcelë tjetër. Përgjegjja e tyre është se kompania ka mjete të peshave të rënda që posedon dhe objektin në fjalë e shfrytëzon vetëm pjesën administrative sepse thotë nuk kemi objekte. Ndërsa, sa i përket objekteve tjera e kemi ish fabrikën e vjetër në Obiliq të vjetër te Hashanët, të cilën ne e shfrytëzojmë në raste emergjente të furnizimit me ujë dhe për parkimin e mjeteve të rënda, makinerinë e mirëmbajtjes eskavatorë e tjera. Atje, ku i kanë nuk është pronë e tyre por e KEK-ut. Ne ju kemi propozue që të iu vazhdohet afati për 10 vite, për arsy se nuk kemi ndonjë plan aty me zhvillue për momentin dhe nëse, ne në të ardhmen planifikojmë mundemi me zhvendosë, ose me ia shkëputë kontratën.

Enver Gashi – Aty është një pronë qysh e ceku edhe kryesuesja 2 ari e 40 metra, ndërtimin e kanë bërë ata vetë, është në shërbim të qytetarëve dhe qytetarët e kanë në qendër për bërjen e ankesave, pagesave, konsultave të ndryshme. Ne jemi për atë që të iu vazhdohet kontrata atyre sepse edhe vetë drejtori tha se për një kohë nuk i duhet Komunës.

Sami Ahmeti – Në jemi pro kësaj kërkese të kësaj ndërmarrje.

Ajet Berisha – Mendoj se duhet të ndjeken procedurat në rast se ne duhet me votue në mënyrë që mos të na kthehet për shkak të mosrespektimit të procedurave. Po ashtu, Drejtoria e urbanizmit e din sikurse për çdo pronë është dashtë me u ndjekë procedura edhe për këtë, që kjo në fund mos të na zgjatet me votim e stërvotim sepse në fund kthehet si diçka që nuk është procedurale.

Labinot Mirena – Unë personalisht jam kundër për arsy se kur është dhënë leja aty, është dhënë për një pozitë të pafavorshme për krejtë ata banorë që janë aty, i ka zënë 2,3 ari aty dhe është ndërtuar një shtëpi në mes të gjitha atyre banesave kolektive që janë aty. Pra, vetëm e ka zënë një pjesë të territorit aty, por për mendimin tim nuk është dashtë me u dhënë leja aty, fare sepse më mirë kishte me qenë një pjesë e gjelbëruar me disa pemë aty, ose një parking që e shfrytëzojnë banorët se sa që e shfrytëzon ujësjellësi për shembull me 3,4 punëtorë që i ka. Edhe kompania Pastrimi e ka të pazgjidhur objektin aty, ku është sepse ka qenë pronë e KEK-ut, tash është e Komunës. Mendoj se kishte me qenë më mirë me shikue dikund ndonjë lokacion më

të përshtatshëm për qytetarët, që 2 kompanitë me qenë afër meqë të dyjat iu shërbejnë qytetarëve të Komunës tonë. Te çështja e pagesave që e tha parafolësi z.Gashi, mund të marrin ndonjë lokal dikund me qira dhe të hiqen nga aty. Mendoj se kjo çështje është mirë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, që të shikohet të gjendet dikund ndonjë parcelë tjetër sepse ajo aty, ku është nuk e meriton me ia vazhdue lejen.

Arben Berisha – Sa i përket çështjes së ligjshmërisë, edhe në shkresë e kam bërë është nen 23 përfundimi i afatit të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale. E keni nën 2, Kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës si dhe të jepë propozim për destinimin e saj. Ne jemi konform ligjt dhe e kemi përshkruar edhe gjendjen e saj, që është me leje ndërtimore komplekt, është duke kryer shërbim. Do të thotë jemi në rregullë me çështjet ligjore dhe nuk besoj se do të kemi ndonjë telashe në këtë drejtim.

Ajet Berisha – Plotësisht pajtohem te neni 2 por thotë me vazhdue me procedurë.

Arben Berisha – Është edhe pika 3 pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, mund ti vazhdohet afati në bazë të performancës. Ne nuk mundemi me publikue sepse duhet me publikue vitin paraprak, por këto që janë në vazhdimin këto, kemi të drejtë me i propozue Kuvendit dhe Kuvendi merrë vendim pro ose kundër, kështu që në baza ligjore jemi në rregullë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 18 vota për 1 votë kundër dhe 1 votë abstenim morën Vendim Aprovohet kërkesa e KUR Prishtina në Obiliq, për vazhdimin e afatit të dhënies në shfrytëzim për 10 vite (deri në vitin 2034) për njësinë kadastrale nr.00687-1 me sipërsaqe prej 240 m² zona kadastrale Obiliq e evidentuar në emër të Komunës së Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkësën nga Zyra e Kryetarit për plotësim ndryshimin e KKSB-së, me anëtaren Fitore Hashani në vend të ish UD-së, drejtorit të DKA-së z.Ibush Mjekiqi.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 14 vota për dhe 1 votë abstenim morën Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-19 të dt.04.02.2022, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) me anëtaren Fitore Hashani emëruar si drejtoreshë në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) sipas vendimit nr.02-104-02-17519-24, të dt.20.06.2024, në vend të ish UD-së, drejtorit të DKA-së z.Ibush Mjekiqi.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti ankesën nga Bekim Rama lidhur me ndërprerjen e vazhdueshme të ujit KUR Prishtina, dega në Obiliq.

Ibush Mjekiqi – Bazuar në ankesat dhe vështirësitet e furnizimit me ujë të qytetarëve nga kompania KUR Prishtina, dje kemi pasë një takim bashkë me drejtorin e shërbimeve publike dhe me zyrtarët e KUR Prishtina, dhe kemi marrë informacione të drejtëpërdrejta se ku qëndron problemi. Natyrish se ka pasë vështirësi për shkak se ka qenë një shpenzim më i madh se ditëve tjera sepse temperaturat ishin më të larta sidomos te familja Rama, Fanaj, Rexhepi, Halimaj që janë në atë zonë atje. Po ashtu, ankesa ka edhe prej fshatit Mazgit sepse edhe në Mazgit nuk është furnizimi qind për qind me ujë, pastaj e kemi pjesën e Milloshevës, krahun e djathë të rrugës drejtimi për Mitrovicë ku vështirësitet kanë qenë edhe te banorët, por sidomos në shkollë për shkak të presionit jo të mjaftueshmë dhe vazhdon deri në Baimoc. Edhe në disa lagje të Plemetinit kemi vështirësi të furnizimit me ujë. Dje kemi marrë premtim dhe jemi sigurue nga drejtori teknik, që brenda një afati shumë të shkurtë do të delë me një propozim teknik për zgjidhje të problemit të familjes Rama, Fanaj, Rexhepi dhe Halimaj. Pra, ka mundësi teknike, që nuk është një kosto e madhe dhe unë u zotova në emër të Ekzekutivit, që me bashkëfinancim do ta zgjidhim këtë problem. Ndërsa, për problemin tjetër të furnizimit të krahut të djathë duke filluar prej Llazarevës deri në Baimoc, e ka zgjidhjen KUR Prishtina por është vendosja e një gypi në gjatësi prej 5 km, që është një investim dikunf mbi 700,000 €, mirëpo sidon që të jetë mbetet në të ardhmen e afërt me mendue që ta zgjidhim këtë problem. Një problem tjetër është prodhimi jo me kapacitet të duhur për shkak të furnizimit nga Albaniku meqë, Ibër Lepenci është duke bërë ndërhyrje në kanalin të cilin e furnizon, kështu që kohë pas kohe kanë problem. Po ashtu, kanë pasë problem të furnizimit me ujë edhe Kozarica dhe Breznica dhe aty ka qenë problemi i një pompe që është rregullue. Javën tjetër ka

mbetë që të vijnë te ne për zgjidhjen emergjente të furnizimit me ujë në lagjen Rama, Fanaj, Rexhepi, Halimaj e familje tjera.

Ajet Berisha – Po aq emergjente është komplet ai krahu që e përmende nga Llazareva, Bakshi, Raskovë, Miloshevë, Baimoc pothuajse 3 muaj verë ata nuk kanë ujë dhe nga qershori deri në shtator ajo pjesë nuk ka ujë, që është një numër i konsiderushëm i qytetarëve, do të thotë flas mbi 3,000 banorë. Pra, mbi 3,000 banorë 3 muaj verë nuk kanë furnizim me ujë. E dyta, është se nga analizat e puseve që i kanë ata, uji është i papijshëm dhe nuk mund të përdoret për shkak të asaj përrooke që kalon nëpër Bakshi dhe Raskovë, uji i atyre puseve është i papijshëm. Kjo, e bën emergjentë intervenimin jo vetëm te familja Rama e Halimaj, por edhe në pjesën tonë veriore që përfshin fshatin Baimoc, Miloshevë, Raskovë, Bakshi dhe Llazarevë.

Ibush Mjekiqi – Nëse, u kuftova drejtë kjo është zgjidhje më e shpejtë që mund të bëhet, e kjo kërkon investim më të madh dhe këtu është problemi, e nuk është problemi se cilën me bë. Të gjithë e dimë me kohë jo vetëm tani se ka vështirësi, e sidomos është problemi i shtypjes së ujit në shkollën “Hasan Prishtina” dhe aty i kemi më se 800 nxënës që frekventojnë brenda ditës dhe vetëm përdorimi i toaleteve shkakton probleme. Edhe kjo është një prej atyre problemeve, pavarësisht duke mos i nënçmuar ata 3,000 banorë që kërkojnë, por në takimet e mëhershme dhe në takimin e ardhshëm që do ta kemi besoj se do të dalim me zgjidhje përkëtë çështje. Unë kërkoj mirëkuptim te qytetarët që nuk mund të furnizohen me ujë sepse e jona është të angazhohemi, por përgjegjësinë e bartë kompania përfshin furnizim me ujë.

Valon Svirca – Gati më shkoj mandati Nënkyetar, disa drita në Mazgit nuk i keni rregullue te parku, do të thotë dritat te parku a do të kryhen brenda mandatit tim, apo në mandatin tjetër.

Ibush Mjekiqi – Sinqerisht, nuk e di dhe tani nuk kam përgjegje.

Valon Svirca – Unë mund ti mbledhi të gjitha procesverbalet me të tregue me datë se unë dhe Valbonë Beka kemi kërkuar vazhdimisht.

Labinot Mirena – Kryesuese, unë e kam një kërkesë lidhur me rezervarët e naftës te nënkalimi që po bëhet atje për banorët, të shihet se qysh është mundësia dhe sa e di unë ata nuk janë duke u shfrytëzuar, por edhe mund të shfrytëzohen këta, rezervarët të naftës, mundësish me i heqë krejtë nga aty. Do të thotë Komuna me shpronësue atë pjesë dhe me ia ndalue atij operimin nëse, e ka për shfrytëzim të rezervarëve të naftës. Unë e di se atij në të kaluarën iu ka dhënë një leje dhe e ka prej zonës urbane 50-100 metra, është banim kolektiv që shfrytëzohet prej qytetarëve aty. Është shëmti e Obiliqit qysh ka ndodhë në të kaluarën me iu dhënë leja në zonën urbane në qendër një njeriu që e ka pasë biznes dhe i ka shfrytëzue rezervarët e naftës.

Ibush Mjekiqi – Ne mundemi me inicue një çështje të tillë përmes Drejtoreve përkatëse, por së pari duhet të dimë pronë e kujt është, pastaj biznesi që zhvillohet aty dhe sidomos që të jetë qysh jemi marrë me disa objekte të tjera merremi edhe me këtë çështje dhe nëse, është e nevojshme edhe me shpronësimin e këtyre tokave.

Labinot Mirena – Nënkyetar, mu në atë pjesë është edhe nënkalimi që bëhet tash për ata banorë andej dhe ai mundet nesër me u funksionalizue sepse ai i ka rezervarët aty, kështu që për qytetarët e Obiliqit mjaft e kemi pasur një deponi, një helm që e kemi pasë në Miloshevë që është heqë. Po ashtu, është një deponi gati me u heqë prej Mirashit, mjaft e kemi KEK-un, që po na sjellë telashe vazhdimisht dhe rezervarët e naftës që i kemi tash, që kishte me qenë më mirë me shpallë Obiliqin, gjendje emergjente që nga këtu me u heqë krejtë.


Ibush Mjekiqi – Ndoshata, e dini edhe ju se në atë pjesën përballë tyre ku ka qenë ambullanta e vjetër është ndarë parcela për ndërtimin e banesave përmes fondit qeveritar dhe ne jemi në mesin e Komunave, pothuajse të vetme që i kemi plotësue kriteret. Do të thotë duhet me pasë tokën, duhet me pasë qasjen në infrastrukturë dhe kjo është një prej arsyeve që duhet të merremi me këtë problematikë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:7'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-20430-29

Nr. i fq. / Br.str. / No.pg.

Data / Datum / Date 18.07.2024

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

IZVOD IZ ZAPISNIKA

